FJALA E ZËVENDËSGUVERNATORIT Z.FATOS IBRAHIMI NË KONFERENCËN:"ROLI I SISTEMIT BANKAR NË PËRMIRËSIMIN E KLIMËS SË BIZNESIT", 17 DHJETOR 2002

TË NDERUAR PJESËMARRËS NË KËTË KONFERENCË!

Nuk është hera e parë që Banka e Shqipërisë, komuniteti i biznesit dhe bankat tregtare, këta tre aktorë të rëndësishëm në jetën ekonomike të një vendi, takohen, diskutojnë, parashtrojnë alternativa e debatojnë me qëllimin e përbashket për t'i dhënë impulse të reja zhvillimit ekonomik të vendit.

Organizimi i kësaj konference ishte një ide e përbashkët e Bankës së Shqipërisë dhe Bankës Kombëtare Greke, e mbështetur fuqimisht edhe nga komuniteti i biznesit nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në të, me qëllimin pozitiv krijimin e një klime cilësisht të re të bashkëpunimit dhe të komunikimit midis tyre, që t'i përgjigjet më mirë stadit aktual në të cilin ndodhet ekonomia shqiptare në prag të hapjes së bisedimeve për nënshkrimin e marrëveshjes së asociim - stabilizimit me Bashkimin Europian.

Jo pak herë secili nga ne është ndodhur përpara pyetjeve: përse niveli i kreditimit të ekonomisë shqiptare është ende larg atij të dëshiruar nga komuniteti i biznesit dhe më gjerë? Përse sistemi i pagesave në kuadrin kombëtar ende nuk është në gjendje të ofrojë shërbime të nivelit bashkëkohor dhe me kosto të ulët? Pse qarkullon një sasi e konsiderueshme kartëmonedhe jashtë kanaleve bankare duke ulur në këtë mënyrë kapacitetet e bankave për të shumëfishuar kreditë? Pse përfaqësuesit e biznesit në shumicë nuk kanë ende stafet e duhura të profesionistëve për t'u paraqitur si partnerë të besueshëm në komunikimin me sistemin bankar? Shumë prej nesh në këtë sallë janë në gjendje të japin përgjigje të argumentuara për pyetjet e mësipërme, t'i shpjegojnë fenomenet duke u nisur nga një kompleks faktorësh që kanë të bëjnë me politikën, me nivelin e zhvillimit ekonomik, me traditën, me mentalitetin, me gjendjen e sistemit të drejtësisë etj., por nuk mundet që t'i shmangin pyetjet e mësipërme.

Për zhvillimin e ekonomisë së një vendi është i rëndësishëm krijimi i një klime të përgjithshme mirëkuptimi midis aktorëve të ndryshëm. Politikat e përgjithshme të zhvillimit ekonomik, afatshkurtra dhe afatmesme, të hartuara nga autoritetet përkatëse qeveritare, luajnë rolin e vet në krijimin e vizioneve të qarta për të ardhmen, ndërsa aktorët e veçantë i plotësojnë në mënyrë komplementare ato në nivelet mikro dhe makroekonomike.

Banka qendrore, me politikat dhe vendimet që merr, ka ndikim të konsiderueshëm në ecurinë e sistemit bankar dhe, për pasojë edhe në ekonominë e vendit. Ky tipar i bën ato të jenë në qendër të vëmendjes së ekonomistëve, të analistëve dhe të tregjeve. Sa më i konsoliduar dhe i konsiderueshëm të jetë sistemi bankar në ekonominë e vendit, aq më shpejt dhe më tepër ndjehen vendimet e bankës qendrore në ekonomi.

Për këtë arsye, Banka e Shqipërisë, nëpërmjet politikës monetare dhe politikës së mbikëqyrjes bankare, ka synuar krijimin e ambjentit të përshtatshëm për një rritje ekonomike, nëpërmjet rritjes së kreditimit të ekonomisë nga sistemi bankar si e vetmja alternativë financimi në kushtet e mungesës së tregut të kapitaleve.

Politika monetare në gjithë këto vite ka patur si tendencë kryesore zbutjen e saj. Në përgjigje të reduktimit të inflacionit dhe të ecurisë së një kursi të qëndrueshëm, norma bazë e interesit mesatarisht është reduktuar. Duhet të kemi parasysh që në fillim të vitit 1998, normat e interesit ishin në nivele mjaft të larta dhe tepër të pafavorshme për aktivitetin huadhënës. Reduktimi në tërësi i normave të interesit, ka krijuar mundësinë që huadhënia e sistemit bankar për biznesin të bëhet më tërheqëse, pasi është reduktuar kostoja e saj. Dhe në fakt, këto vite, por më e spikatur në vitet 2001-2002, huadhënia e bankave është rritur ndjeshëm. Pavarësisht se ajo ende nuk është në nivelet e dëshirueshme apo në nivelet

e ekonomive të tjera, ritmet e rritjes kanë qenë të shpejta. Kjo tregon që bizneset shqiptare, gjithnjë e më tepër, interesohen të përdorin huadhënien bankare si burim financimi. Nga ana tjetër, ky është një tregues që edhe vetë bankat janë më të prirura të angazhohen në kreditim në përgjigje të një ambjenti dhe të një klime ekonomike më të qëndrueshme e të përmirësuar.

Banka e Shqipërisë, në cilësinë e autoritetit rregullator dhe të mbikëqyrjes, kontribuon në përmirësimin e klimës së biznesit me politikën dhe me vendimet e saj, në drejtim të çeljes së bankave të reja, të lejimit të hyrjes së bankave të huaja në tregun shqiptar si dhe të forcimit të mbikëqyrjes mbi to. Shtimi i numrit të bankave, të degëve të bankave dhe shtrirja e tyre e gjerë në të gjithë vendin, ka krijuar më tepër ofertë për shërbime bankare. Është e qartë që, një ekonomi tregu e zhvilluar nuk mund të kuptohet pa bankat. Rritja e aktivitetit bankar pikërisht do të ndihmojë në lidhjen më të mirë të sektorit bankar me pjesën tjetër të ekonomisë. Së fundi, vetë forcimi i mbikëqyrjes bankare çon në shëndoshje të sistemit bankar, çon në një kontribut të dobishëm të tij në eknominë e vendit dhe rrit fuqinë e sistemit bankar në drejtim të financimit të ekonomisë.

Sigurisht që një konferencë nuk mundet t'u japë zgjidhje të gjitha çështjeve që shqetësojnë raportin biznes-bankë, por vlen për t'u theksuar gatishmëria me të cilën e priti organizimin e kësaj konference komuniteti i biznesit dhe bankat, si dy partnerë të rëndësishëm dhe promotorë të zhvillimit ekonomik.

Duke shprehur edhe një herë besimin tek suksesi i konferencës, shpreh bindjen se partneriteti institucional midis aktorëve të ndryshëm ekonomikë është element i rëndësishëm për të krijuar klimën e nevojshme për aktivitetin e sektorit privat në ekonominë shqiptare.

Faleminderit!